

Deklaratë e anëtarëve të Grupit Drejtues Ndërkombëtar për mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

22 korrik 2010, Prishtinë, Republika e Kosovës

Grupi Drejtues Ndërkombëtar mirëpret mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për pyetjen e deklarimit të pavarësisë së Kosovës. Grupi Drejtues Ndërkombëtar rikonfirmon mbështetjen e palëkundur të tij për pavarësinë e pakthyeshme të Kosovës demokratike dhe shumetnike në kufijtë e saj të tanishëm dhe i bën thirrje shteteve tjera që të njohin Kosovën. Ai po ashtu përshëndet përkushtimin e vazhdueshëm të Kosovës dhe progresin e konsiderueshëm në zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe do të vazhdojë të mbështesë Kosovën në punën për realizimin e perspektivës së saj evropiane.

Mendimi këshillues i GJND-së është një mundësi e rëndësishme që Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë të fillojnë një fazë të re në marrëdhëniet e tyre. Grupi Drejtues Ndërkombëtar shpreson që të ketë dialog të sigurtë, konstruktiv dhe me respekt mes Serbisë dhe Kosovës, si shtete të pavarura dhe sovraane, për të identifikuar dhe zgjidhur çështjet praktike me interes të përbashkët, në të mirë të qytetarëve të të dyja vendeve. Grupi Drejtues Ndërkombëtar e përshëndet gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për tu angazhuar mbi këtë bazë, duke besuar se një dialog dhe bashkëpunim i tillë është në të mirë të stabilitetit afatgjatë të rajonit dhe integritetit evropian.